



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË
ORGANIZUAR**

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 7.4.2025

Lënda: Bisedimet përfundimtare të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në çështjen me objekt: ankim kundër vendimit nr. 539, datë 8.6.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Hysni Mulaj

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 dhe 8 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Për kompetencë: Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pranë Gjykatës Kushtetuese

Të nderuar gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit!

Në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor, në referencë të nenit 302 dhe 303 të Kodit të Procedurës Civile, pasi u administruan, shqyrtuan dhe iu nënshtruan debatit gjyqësor të gjitha shkaqet e ankimit të datës 22.7.2022, prapësimet dhe aktet e administruara në cilësinë e provës në funksion të shkaqeve të ankimit, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në referencë të përmbajtjes së akteve të administruara dhe nivelit të provueshmërisë së tyre në lidhje me shkaqet e ankimit, parashtron si vijon:

I. Mbi vlerësimin e kriterit të pasurisë

1. Për pasurinë “*Apartament banimi me sipërfaqe 101,4 m², me vendodhje Tiranë*”, sa i përket shkakut të ankimit *mbi burimet e ligjshme të personit tjetër të lidhur* (babai i subjektit të rivlerësimit z.*** ***), i cili deklarohet në cilësinë e huadhënësit për shumën e dhënë hua në vitin 2004 në vlerën 4.000.000 lekë dhe në cilësinë e dhuruesit për shumën e deklaruar dhuruar në vitin 2005 në vlerën 500.000 lekë, gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur akte të cilat u administruan në cilësinë e provës nga trupi gjykues i Kolegjit.

1.1 **Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme**, në referencë të parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit z. Hysni Mulaj dhe akteve të depozituara prej tij në Kolegj, konstaton se:

1.1.1 Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e depozituara në Kolegj, ka mbajtur të njëjtin qëndrim si dhe gjatë hetimit administrativ në Komision, përse i përket ekonomisë së

përbashkët familjare, kontributit të tij dhe vëllezërve të tij në këtë ekonomi si dhe administrimin e të ardhurave të përbashkëta nga i ati, z. *** ***, i cili njëkohësisht është huadhënës dhe dhurues i shumave të deklaruara të përdorura për blerjen e pasurisë së subjektit të rivlerësimit.

1.1.2 Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar përshirjen në mesin e burimeve të ligjshme të huthënës/dhuruesit të të ardhurave të vëllait të tij, z.*** ***, për vitet 2003-2004, si pjesë e ekonomisë së përbashkët familjare, në funksion të verifikimit të mundësisë financiare të personit tjetër të lidhur për të mbuluar me burime të ligjshme shumat prej 4.000.000 lekë deklaruar hua në vitin 2004 dhe 500.000 lekë, deklaruar dhuruar subjektit të rivlerësimit në vitin 2005.

1.1.3 Subjekti i rivlerësimit ka mbajtur të njëjtin qëndrim edhe përsa i përket të ardhurave shtesë të përfituara nga familja e origjinës, nga aktiviteti tregëtar si dhe nga shitja e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale, të cilat kanë shërbyer, ndër të tjera edhe për konsum jetik, pretendim ky i përsësitur gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, në funksion të reduktimit të shpenzimeve të jetesës së familjes së origjinës.

1.1.4 Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në cilësinë e provës, gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, aktet si vijon:

- i. Kontratë pune e datës **.2.2003, në emër të punëmarrësit *** ***, e përkthyer në gjuhën shqipe, noterizuar dhe apostiluar;
- ii. Vërtetim i datës **.5.2020, i “*** ***”, e përkthyer në gjuhën shqipe noterizuar dhe apostiluar;
- iii. Deklaratë e datës **.5.2020 e përkthyer në gjuhën shqipe, noterizuar dhe apostiluar, e shtetasit *** ***,
- iv. Vërtetim i datës **.1.2025, i *** ***, e përkthyer noterizuar dhe apostiluar; (Administratore e shoqërisë “*** ***)
- v. Listë-pagesa për pagën neto dhe bruto për shtetasin *** ***, për periudhën Janar 2003 – dhjetor 2005, datë **.1.2025, përkthyer, noterizuar dhe apostiluar;
- vi. Deklaratë noteriale nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë **.03.2025, e deklaruesit Hysni Mulaj dhe akte bashkëlidhur¹;
- vii. Certifikatë martese datë **.2.2025 e shtetasit *** ***,
- viii. Kthim përgjigje nr. *** datë **.3.2025 nga *** *** Tiranë, për shtetasin *** ***,
- ix. Kthim përgjigje nr. *** datë **.3.2025 nga *** *** Tiranë, për shtetasin *** ***,
- x. Certifikatë familjare e shtetasit *** *** datë **.12.2024;
- xi. Certifikatë familjare e shtetasit *** *** datë **.12.2024;
- xii. Kontratë për Shërbime Ujësjetësi nr. **, nënshkruar më datë **.2.2018 dhe Aplikim për lidhe të re pranë OSShE-së, nënshkruar më datë **.11.2014, noterizuar me nr. *** rep., datë **.3.2025.

¹ Vërtetim fiskal për kërkuesin *** *** i lëshuar në mënyrë elektronike nga portal MyMinfin si dhe të dhëna të entitetit *** me administrator *** ***, ***, të regjistruar në Bazën e të Dhënave të Ndërmarrjeve me aktivitetet që prej datës **.09.2001, përkthyer dhe në gjuhën shqipe nga përkthyes zyrtar ***.***.

1.1.5 *Lidhur me të ardhurat e pretenduara nga i vëllai i subjektit të rivlerësimit z.*** ***, aktet e mësipërme, listuar nga i-vi, të paraqitura gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, vlerësuar në harmoni me parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, lidhur me administrimin dhe ruajtjen e dokumentave fiskalë nga shteti Belg², provojnë të ardhurat e ligjshme të shtetasit *** *** nga punësimi pranë shoqërisë “*** ***” për vitet respektive, të pretenduara nga subjekti gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, në vlerën totale neto për vitet 2003-2005 prej 47.096.27 euro.*

1.1.5.1 Gjithashtu, në funksion të analizës financiare mbi mundësinë e kursimit të këtij shtetasi, vlerësohet të mbahen në konsideratë aktet e vëna rishtaz në dispozicion gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, mbi gjendjen familjare të tij, nga të cilat konstatohet se ky shtetas ka lidhur martesë në vitin 2016.

1.1.5.2 Në funksion të sa më sipër, vlerësohen dhe aktet e paraqitura nga subjekti, gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, kthim përgjigje nga “*** *** Tiranë”, mbi detyrimin e kësaj shoqërie për administrimin e të dhënave të klientëve, deri në pesë vjet pas datës së përfundimit të marrëdhënies me klientin.

1.1.6 *Lidhur me të ardhurat e pretenduara nga i vëllai i subjektit të rivlerësimit z.*** ***, subjekti i rivlerësimit, gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj mbajti të njëjtin qëndrim lidhur me jetesën e përbashkët. Lidhur me këtë shkak, vlerësojmë se duhen mbajtur në konsideratë sa depozituar nga subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, mbi përbërjen familjare të këtij shtetasi, referuar certifikatës familjare të depozituar (prova nr. xi) dhe akteve të depozituara në funksion të provueshmërisë mbi momentin e shkëputjes *de facto* nga familja e origjinës, për shtetasin *** *** (prova nr. xii).*

1.1.7 Në këto kushte, referuar sa më sipër, pas analizimit të akteve të depozituara rishtazi nga subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, vlerësohet se në mesin e burimeve të ligjshme të personit tjetër të lidhur, duhet të përfshihen edhe të ardhurat e ligjshme të shtetasit *** *** nga punësimi në shtetin Belg, për vitet respektive³ 2003-2005, si dhe të ardhurat dhe shpenzimet sipas përbërjes familjare të vëllait tjetër, shtetasit *** ***.

1.1.8 *Përsa i përket shumës së deklaruar të dhuruar në vitin 2005, prej 500.000 lekë, po në vlerësim të akteve të depozituara nga subjekti gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, (provat i.-vi.), vlerësohet se provohen dhe burimet e ligjshme të personit tjetër të lidhur (babai i subjektit të rivlerësimit), në kuadër të ekonomisë së përbashkët familjare, për dhurimin kësaj shume.*

1.1.9 Në përfundim për këtë shkak ankimi, vlerësohet se për sa rezultuar nga debati gjyqësor dhe shqyrtimi i çështjes në Kolegj, trajtuar gjerësisht më sipër, në konsideratë edhe të rrethanave të mëposhtme, si:

1.1.9.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shumën prej **4.000.000 lekë**, marrë hua nga babai, në vitin 2004 në: (i) në *Deklaratën Veting*, si burim për pasurinë *apartament banimi me sipërfaqe 101,4 m²*, huanë prej 4.000.000 lekë, marrë babait të tij z. *** ***; (ii) në *Deklaratën e pasurive, detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë*,

² Referohu trajtimit në parashtrimet e subjektit në seancën e datës 2.4.2025 në Kolegj, fq. 12.

³ Duke zbritur shpenzimet e jetesës sipas Eurostat për këtë shtetas për të njëjtën periudhë.

të vitit 2004, dorëzuar në ILDKPKI në datë **.3.2005; (iii) Në deklaratat periodike vjetore për vitet 2006 - 2010, ka deklaruar rregullisht shlyerje pjesore të kësaj huaje ndërsa në deklaratatën Vetting ka deklaruar detyrimin e mbetur ndaj huadhënësit;

1.1.9.2 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shumën prej **500.000 lekë**, dhuruar nga babai, në vitin 2005 në: (i) Në *Deklaratën e Interesave Privatë Periodik Vjetor të vitit 2005*, shumën 500.000 lekë marrë *cash* më datë **.1.2005 nga babai *** ***; (ii) Në deklaratën Vetting shumën 500.000 lekë marrë nga babai në formë dhurate;

1.1.9.3 Gjatë hetimit administrativ në Komision ashtu dhe gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, subjekti ka mbajtur të njëjtin qëndrim mbi burimet e huadhënësit, ndërkohë gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, subjekti ka depozituar akte të reja lidhur me provueshmërinë e këtyre burimeve, të cilat janë administruar në cilësinë e provës;

1.1.9.4 Gjatë hetimit administrativ është provuar se: (i) në pronësi të familjes së origjinës janë disa sipërfaqe të konsiderueshme tokë bujqësore, ku kultivohen prodhime bujqësore dhe blegtorale, nëpërmjet të cilave është ndihmuar ekonomia familjare; (ii) është provuar ekzistenca e aktivitetit tregtar të të atit në vendin e origjinës, aktivitet nga i cili janë gjeneruar të ardhura, të cilat gjithashtu vlerësohet se kanë ndihmuar ekonominë familjare;

1.1.10 Vlerësojmë se, për sa trajtuar gjerësisht më sipër, mbi përfshirjen në mesin e burimeve të ligjshme të të ardhurave nga vëllezërit *** dhe *** ***, si dhe të ardhurat nga punësimi i vetë subjektit të rivlerësimit, diferenca negative që do të rezultonte nga analiza financiare e familjes së origjinës, për të mbuluar me burime të ligjshme shumën prej 4.000.000 lekë, deklaruar dhënë hua subjektit të rivlerësimit në vitin 2004, do të ishte në një masë të tillë, që nuk mund të penalizojë subjektin e rivlerësimit në këtë proces. Aktet e depozituara gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor, sikundër cituar më sipër, vlerësohet se provojnë dhe burimet e ligjshme të personit tjetër të lidhur (babai i subjektit të rivlerësimit) për dhurimin e shumës prej 500.000 lekë në vitin 2005, deklaruar në deklaratën periodike vjetore të po këtij viti nga subjekti i rivlerësimit.

2. *Sa i përket shkakut të ankimit mbi burimet e ligjshme të vetë subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, për të mbuluar shpenzimet dhe kursimet e viteve 2003-2016*, subjekti i rivlerësimit përveç përfshirjes në mesin e burimeve të ligjshme të personit tjetër të lidhur, edhe të të ardhurave të shtetasit *** ***, (të cilat ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në uljen e pamjaftueshmërisë financiare të vitit 2005), ka pretenduar ndër të tjera, edhe: (i) rishikimin e ndryshimit të likuiditeve për vitet 2007⁴; (ii) rishpërndarjen e shpenzimeve të mobilimit të apartamentit, sipas përgjigjeve të tij në prapësimet e datës **.5.2022 drejtuar Komisionit.

2.1 Në këto kushte, në kuadër të sa analizuar gjerësisht më sipër, vlerësohet se diferenca negative që do të rezultonte për periudhën e analizuar 2003-2016, pas rishikimit të pretendimeve të subjektit për përfshirjen e shumës së dhuruar nga i ati prej 500.000 lekë në vitin 2005 dhe rishpërndarjes së shpenzimeve të mobilimit në vlerat e deklaruara prej tij, nuk është e mjaftueshme për të cënuar nivelin e besueshmërisë në drejtim të kriterit të vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit.

⁴ Referohu trajtimit të subjektit në fq. 8 dhe 23 të parashtrimeve.

II. Kërkimi i ankimit

3. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në përfundim të këtyre bisedimeve, në kushtet kur mangësitë e konstatuara për vlerësimin e kriterit të pasurisë, janë shteruar gjatë gjyqimit në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, bazuar në dispozitën e pikës 7 nenit F të aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, kërkon nga ana e Kolegjit të vendosë:

- Lënien në fuqi të vendimit nr. 539, datë 8.6.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit zotit Hysni Mulaj.

DREJTUESI I PROKURORISË

PROKURORI I AUTORIZUAR

Altin DUMANI

Klodjan BRAHO